



WESTERN BALKAN NETWORK  
ON TERRITORIAL GOVERNANCE

# LETËR POZICIONIMI E RRJETIT TË BALLKANIT PERËNDIMOR PËR QEVERISJEN TERRITORIALE

---

**Rrjeti i Ballkanit Perëndimor për Qeverisjen Territoriale** | TG-WeB |

**Shtator 2018**

## Shënim i Autorit:

Kjo Letër Pozicionimi pasqyron të dhënat dhe informacionet e mbledhura nga të gjithë anëtarët e Rrjetit të Ballkanit Perëndimor për Qeverisjen Territoriale, të dhënat e kontaktit të të cilëve mund ti gjeni në Shtojcën 1.

- **Co-PLAN, Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit**, Shqipëri: Rudina Toto; Dritan Shutina; Anila Bejko; Aida Ciro; Ledio Allkja; Lorena Gjana
- **Qendra për Analiza Ekonomike (CEA)**, Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë: Marjan Nikolov
- **DIST - Departamenti Ndërunivesitar i Studimeve dhe Planifikimit Rajonal dhe Urban**, Universiteti Politeknik i Torinos, Itali: Giancarlo Cotella; Erblin Berisha
- **Universiteti POLIS**, Shqipëri: Besnik Aliaj; Ledian Bregasi; Llazar Kumaraku; Loris Rossi; Sotir Dhamo; Peter Nientied
- **Koalicioni për Zhvillim të Qëndrueshëm**, Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë: Sonja Damchevska
- **IPoP – Instituti për Politikat Hapësinore**, Slloveni: Marko Peterlin
- **MRI – Instituti i Kërkimeve Metropolitane**, Hungari: Iván Tosics
- **Instituti për Parashikimin Hapësinor**, Luksemburg: Kai Böhme
- **Universiteti Sllovak i Teknologjisë në Bratislavë | SPECTRA, Qendra e Ekselencës së BE-së në STU**, Sllovakia: Maros Finka
- **EXPEDITIO, Qendra për Zhvillimin Hapësinor të Qëndrueshëm**, Mali i Zi: Biljana Gligorić, Aleksandra Kapetanovic; Tatjana Rajić; Sonja Dragovic
- **Aleanca Kombëtare për Zhvillimin Ekonomik Lokal (NALED)**, Serbi: Jelena Bojovic; Ana Ilic
- **InTER - Instituti për Zhvillimin Ekonomik të Territorit**, Serbi: Dragisa Mijacic Jasna Žarković
- **GAP, Instituti i Studimeve të Avancuara**, Kosovë: Bekim Salihu
- **Shoqata për Kërkim Shkencor dhe Inovacion Social ADT**, Bosnje dhe Hercegovinë: Elma Demir
- **EURAK Beograd**, Serbi: Sanja Kmezic
- **Instituti i Financave Publike**, Kroaci: Katarina Ott
- **Velislava Simeonova**, Bullgari: Qendra Ndërkombëtare Universitare e Barcelonës
- **Ivaylo Stamenkov**: Universiteti i Sofjes, Bullgari
- **Forumi Ndërkombëtar Shkencor “Danubi - Lumi i Bashkëpunimit”**, Serbi: Edita Stojčić Karanović
- **Siniša Trkulja**: Ministria e Ndërtimit, Transportit dhe Infrastrukturës, Serbi

Çdo koment apo përgjigje për këtë letër pozicionimi mund të dërgohet nëpërmjet një shkrese ose me email në adresën:

Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit  
Rruga Bylis 12, Kashar, KP 2995, Tiranë, Shqipëri  
info@tg-web.eu

---

\*Ky emërtim nuk cenon qëndrimet për statusin dhe është në përputhje me Rezolutën 1244/1999 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara dhe opinionin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë për deklaratën e pavarësisë së Kosovës.

## Tabela e Përmbajtjes

Përmbledhje Ekzekutive.....	4
Hyrje.....	6
I. Pritshmëritë e Rajonit.....	7
II. Dimensioni Territorial dhe Urban i Perspektivës së Zgjerimit.....	8
III. Sfidat e Qeverisjes Territoriale në Vendet e Ballkanit Perëndimor.....	9
IV. Roli i Qeverisjes Territoriale në mbështetje të Perspektivës së Zgjerimit të BE-së për Ballkanin Perëndimor.....	11
V. Rekomandime: Qeverisja Territoriale në Ballkanin Perëndimor brenda kuadrit të Zbatimit të Perspektivës së Zgjerimit.....	13
Shtojca 1.....	16

## Përmbledhje Ekzekutive

Të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor kanë të përbashkët një aspiratë për një të ardhme në Bashkimin Evropian (BE). Si rajon, sistemet dhe praktikat tona të qeverisjes territoriale përballen me mangësi të ngjashme që e bëjnë sfiduese zbatimin e politikave të BE-së në praktikë. Këto sfida po zhvillohen në një kontekst ku BE-ja nuk e ka përfshirë Ballkanin Perëndimor në përpjekjet e saj për të përmirësuar *Qeverisjen Territoriale*, duke bërë që në këto momente dhe në të ardhmen vendet të gjenden të pa përgatitura për të trajtuar zhvillimin territorial si në BE ashtu edhe brenda vendit.

Duke qenë se BE-ja kohët e fundit ka rikonfirmuar perspektivën e saj për zgjerimin, në kuadër të këtij rrjeti, ne e shohim këtë si një moment i përshtatshëm për të prezantuar në mënyrë të qartë *Qeverisjen Territoriale* në agjendën e zgjerimit. Ne, *Rrjeti i Ballkanit Perëndimor për Qeverisjen Territoriale*, sugjerojmë që *perspektiva* e besueshme e zgjerimit mund të japë më shumë rezultate në kuadrin e qeverisjes territoriale për të trajtuar dhe ofruar një zgjidhje të besueshme për **problematikat themelore strukturore**. Këto problematika themelore ndikojnë në përmbushjen me sukses të objektivave parësore të perspektivës së zgjerimit; përbëjnë barriera thelbësore për zhvillimin e qëndrueshëm të Ballkanit Perëndimor; dhe janë kritike për arritjen e integritit ndër-rajonal. Nëse arrijmë të trajtojmë këtë çështje, ne besojmë se *perspektiva* e zgjerimit do të kishte një potencial më të madh për të dhënë rezultatet e shumëpritura:

- ***Ndryshimet klimatike dhe mjedisi:*** Integrimi social-ekonomik i Ballkanit Perëndimor në BE mund të arrihet vetëm duke u vënë në linjë të njëjtë me një **përdorim inteligjent dhe të përbashkët të burimeve natyrore. Ekosistemi dhe qeverisja e bazuar në adaptim** duhet të përbëjnë pikat thelbësore për tu marrë në konsideratë gjatë procesit të integritit, siç është diskutuar publikisht gjatë ndërveprimeve ndërmjet BE-së dhe vendeve të Ballkanit Perëndimor.
- ***Energjia e Rinovueshme dhe Rrjetet e Energjisë*** BE-ja duhet të harmonizojë sistemet e energjisë me Ballkanin Perëndimor dhe t'i kushtojë një vëmendje praktike ekonomisë qarkulluese. BE-ja duhet të **mbështesë në mënyrë aktive** krijimin e sistemeve të **energjisë së rinovueshme**, të kufizojë përdorimin e lëndëve djegëse fosile, të parandalojë importin e teknologjive të vjetruara nga vendet e tjera dhe gjithashtu të ndalojë ndërtimin e hidrocentraleve për të gjitha nivelet e rrymës.
- ***Emigrimi:*** Emigrimi aktual dhe kriza e refugjatëve mbetet një **sfidë për qeverisjen, e cila duhet trajtuar gjatë procesit të integritit**. Ulja e numrit të popullsisë lokale dhe forcës punëtore, e marrë së bashku me menaxhimin e dobët të krizës së refugjatëve, rrit paqëndrueshmërinë demografike dhe socio-ekonomike në rajon.
- ***Tregu i Punës dhe Punësimi:*** BE-ja duhet ta përqendrojë dhënien e mbështetjes së saj në programet që **parandalojnë largimin e trurit dhe të mbajë fuqinë punëtore lokale në Ballkan**, duke fokusuar investimet në sipërmarrjet e reja, NVM-të, infrastrukturën e konektivitetit, përmirësimin dhe menaxhimin e përbashkët të burimeve natyrore dhe veçanërisht në **arsim dhe institutet dhe nismat lokale të kërkimit shkencor dhe zhvillimit**.
- ***Transporti:*** Prioriteti i përmirësuar për krijimin e lidhjeve duhet t'i kushtojë **vëmendje të veçantë si sistemeve hekurudhore ashtu edhe autostradave** që lidhin Ballkanin Perëndimor me korridoret evropiane, për të arritur **vazhdimësi të integruar territoriale**.

- **Zhvillimi rajonal dhe Kohezioni:** Zbatimi i *perspektivës* së zgjerimit kërkon krijimin e **sistemeve të hapura të informacionit dhe komunikimit**, të cilat lejojnë përfshirjen e perspektivave të Ballkanit Perëndimor në politikat e BE-së. Zbatimi i *perspektivës* së zgjerimit duhet të përfshijë planifikimin e zhvillimit me qëllim arritjen e një qëndrueshmërie territoriale, ndërkohë që BE-ja ofron më shumë mbështetje për popullsinë lokale dhe shoqërinë civile si një mjet për **t'u kërkuar llogari qeverive për zbatimin e reformave**.
- Instrumentet e BE-së për zbatimin e *perspektivës* së zgjerimit duhet të sigurojnë **ekuilibrin e duhur të instrumenteve ndihmëse dhe mbështetjes** mes niveleve të qeverisjes dhe palëve të interesit. Për këtë, ka nevojë të zbatohet një koordinim dhe planifikim më i mirë i donatorëve për **të harmonizuar të gjitha nismat** dhe për të përmbushur kriteret e anëtarësimit në BE.
- Si përfundim, **njohuritë** që lindin nga vënia në zbatim e instrumenteve territoriale si CLLD<sup>1</sup> dhe ITI<sup>2</sup> duhet të **transferohen** në rajon, me qëllim që të përforcohet **kuptimi i qasjes sipas vendit dhe parimit të partneritetit**, të cilat janë thelbësore për qeverisjen territoriale.

---

1 Zhvillimi lokal nën drejtimin e komunitetit  
2 Investime të Integruara Territoriale

## Hyrje

Të gjitha vendet e rajonit të Ballkanit Perëndimor - Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë, Kosova, Mali i Zi dhe Serbia - kanë të përbashkët një aspiratë për një të ardhme brenda BE-së, pavarësisht diversitetit dhe veçantive të tyre. Duke qenë një rajon me më shumë se 20 milionë banorë, vendet kanë shumë ngjashmëri në lidhje me zhvillimin dhe agjendat e tyre të integritit dhe përballen me mangësi të ngjashme në qeverisjen territoriale dhe sistemet dhe praktikën e planifikimit. **Ky nivel kompleksiteti kanë bërë që zbatimi i politikave të BE-së në praktikë të jetë mjaft sfidues.**

Megjithëse BE-ja ka dedikuar përpjekje të mëdha dhe fonde të konsiderueshme për të arritur një qeverisje më të mirë territoriale dhe integritet të politikave të saj, ajo nuk i ka përfshirë ende vendet e Ballkanit Perëndimor. Për rrjedhojë, kur Ballkani Perëndimor të jetë përfundimisht pjesë e BE-së, si vendet e BE-së ashtu edhe vendet e Ballkanit Perëndimor do të gjenden të papërgatitur për të përballuar zhvillimin territorial si nga këndvështrimi i BE-së ashtu edhe nga këndvështrimi i vendeve përkatëse. Në këto kushte, **sfidat e Ballkanit Perëndimor janë të dyfishta**, kombinimi i qeverisjes së dobët territoriale vendase me mundësi të kufizuara për të kontribuar në mënyrë aktive në diskutimet e politikave të BE-së nëpërmjet njohurive dhe reagimeve të marra nga vendet e Ballkanit Perëndimor. Mospërbushja e këtyre sfidave do të sjellë si rezultat një administrim të dobët dhe jo etik të burimeve, planifikim jo të përshtatshëm, hartim jo gjithëpërfshirës të politikave, pabarazi të mëdha territoriale dhe prioritetet konfliktuale [të copëzuara] të zhvillimit.

Ndërkohë që BE-ja rikonfirmon perspektivën e saj për zgjerimin, në kuadër të rrjetit që përfaqësojmë, ne e shohim këtë si moment të përshtatshëm që të prezantohet Qeverisja Territoriale në agjendën e zgjerimit të prioritetëve të zhvillimit dhe integritit për një sërë arsyesh që janë të dobishme si për BE-në dhe për rajonin. Qeverisja Territoriale është një koncept relativisht i ri në Evropë. Është një koncept kompleks dhe ndër më të rëndësishmit, por premtues dhe shumë i rëndësishëm për procesin e **evropianizimit** të rajonit në tre nivele: (i) thekson dimensionin territorial/sipas vendit të hartimit të politikave; (ii) mundëson bashkëpunimin dhe përfshirjen e palëve të interesit; dhe (iii) është me orientim strategjik dhe veprues.

Ne, *Rrjeti i Ballkanit Perëndimor për Qeverisjen Territoriale*, një grup organizatash të shoqërisë civile që veprojnë në Shqipëri, Bosnje dhe Hercegovinë, Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë, Kosovë, Mali të Zi dhe Serbi dhe me mbështetjen e plotë të organizatave anëtare të rrjetit nga vendet anëtare të BE-së, duke përfshirë Kroacinë, Hungarinë, Italinë, Luksemburgun, Holandën, Sllovakisë dhe Slloveninë, paraqesim këtë raport argumentues për Qeverisjen Territoriale në Ballkanin Perëndimor kundrejt "Perspektivës së besueshme të zgjerimit dhe angazhimit të theksuar të BE-së me Ballkanin Perëndimor"<sup>3</sup>

Raporti argumentues ka përshtatur një perspektivë makro rajonale për identifikimin dhe propozimin e disa rekomandimeve për mënyrën si Qeverisja Territoriale mund të luajë një rol në procesin e integritit të Ballkanit Perëndimor në Bashkimin Evropian, duke trajtuar sfidat e zhvillimit dhe qeverisjes në rajon.

3 Në vijim referuar si 'perspektiva e zgjerimit' ose thjesht 'perspektiva'.

## I. Pritshmëritë e Rajonit

*A i përmbush perspektiva e zgjerimit të BE-së për Ballkanin Perëndimor pritshmëritë e një perspektive për vendin/rajonin?*

Gjatë takimin në Selanik në vitin 2003, Këshilli Evropian ofroi një perspektivë të BE-së për vendet e Ballkanit Perëndimor. Pas pesëmbëdhjetë vitesh dhe reformash të shumta (në tentativë), kjo *perspektivë* ofrohet përsëri përmes “Perspektivës së besueshme të zgjerimit dhe angazhimit të theksuar të BE-së me Ballkanin Perëndimor”, botuar në shkurt të vitit 2018.

Parë nga perspektiva e BE-së, anëtarësimi i vendeve të Ballkanit Perëndimor përbën një investim gjeostrategjik për atë që përkufizohet si “interesi i saj politik, ekonomik dhe i sigurisë” për një “Evropë të qëndrueshme, të fortë dhe të bashkuar e bazuar në vlera të përbashkëta”. Kjo përbën për një konfirmim shumë të mirëpritur të qëllimeve të zgjerimit në të gjithë rajonin. *Perspektiva* e zgjerimit e njeh perspektivën evropiane drejt Ballkanit Perëndimor nga këndvështrimi gjeografik, kulturor dhe historik, dhe e vendos theksin te e ardhmja e tij si një pjesë integrale e BE-së.

Si rrjet, ne gjithashtu e përgëzojmë shumë perspektivën e zgjerimit për rivendosjen e tonalitetit dhe urgjencës së nevojës për të përmbushur kriteret e nenit 49 të Traktatit të BE-së, duke përfshirë kriteret e Kopenhagenit, vendosjen në dispozicion të të paktën tre reformave kryesore dhe zgjidhjen e çdo mosmarrëveshjeje dypalëshe.

*Perspektiva* e besueshme e zgjerimit për rajonin vendos në qendër të vëmendjes shtetin e së drejtës, trajtimin e dobësive strukturore në lidhje me një ekonomi funksionale dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dypalëshe. Sidoqoftë, ne si rrjet mendojmë se *perspektiva* e zgjerimit mund të kishte ofruar një “zgjidhje të besueshme” të shumëpritur

për problemet strukturore që ndikojnë në përmbushjen e suksesshme të *perspektivës* së zgjerimit në secilin nga vendet e Ballkanit Perëndimor dhe të kishte bërë më shumë për të trajtuar këto çështje strukturore. Në fakt, në mënyrë që objektivat të jenë më të besueshme dhe realiste, dhe që të ndodhë transformimi i thellë shoqëror, duhet të ndodhin ndryshime të mëdha. Këto përfshijnë gatishmërinë modeste të qeverive për të zbatuar reformat që çojnë në uljen e ndikimit të strukturave në pushtet; ndjekjen penale të shumë figurave politike të përfshira në skemat e korrupsionit dhe grupet e krimin të organizuar; si dhe ndryshime të tjera.

*Perspektiva* e zgjerimit paraqet disa prioritete, të cilat janë mjaft të rëndësishme nga pikëpamja e Bashkimit Evropian. Ndërkohë që vendet e Ballkanit Perëndimor janë të lidhura në nivel kombëtar, perspektiva rajonale tregon realitete të ndryshme lokale dhe për rrjedhojë edhe prioritete të tjera shtesë. Në një Evropë kaq të larmishme, integrimi duhet të jetë një proces i ndërsjellë midis vendeve që aspirojnë të anëtarësohen dhe komunitetit pritës. Ndërsa të ardhurit rishtazi duhet të përmbushin kërkesat e Bashkimit Evropian, BE-ja duhet të njohë sfidat lokale të integritetit dhe të jetë e përgatitur për t'i trajtuar ato gjatë procesit. Për shembull, problematikat e zhvillimit të ekuilibruar rajonal të brendshëm, problematikat lidhur me të drejtat e pronësisë, shfrytëzimi i paqëndrueshëm i burimeve natyrore, mbrojtja e pamjaftueshme e mjedisit që i vendos sistemet socio-ekologjike e të gjitha shkallët e rrezikut dhe një sektor energjetik në rritje, por që shkakton gjithnjë e më shumë ndotje, përbëjnë disa nga sfidat kryesore për rajonin.

Vendet e Ballkanit Perëndimor janë në faza të ndryshme të procesit të anëtarësimin në BE, duke përparuar në rrugën e tyre

evropiane në bazë të meritave individuale të veçanta. Ndërkohë kjo gjë është normale, nuk duhet të shkaktojë ndryshime të thella të kohës së anëtarësimit të të gjitha vendeve, pasi kjo do të pengonte ambicien për t'u integruar në BE si rajon. Njëkohësisht, duhet që vendet e Ballkanit Perëndimor të pranojnë se integrimi nuk është e njëjta gjë me anëtarësimin. Në këtë kuptim, **integrimi ndër-rajonal** duhet të kthehet në prioritet për Ballkanin Perëndimor bashkë me proceset aktuale të integritit dhe anëtarësimit në BE.

## II. Dimensioni Territorial dhe Urban i Perspektivës së Zgjerimit

*A i trajton perspektiva e zgjerimit sfdat dhe realitetet e Qeverisjes Territoriale, dhe nëse jo, pse duhet ta bëjë?*

Edhe pse *perspektiva* bindëse e zgjerimit për Ballkanin Perëndimor nuk e përmban qeverisjen territoriale dhe urbane si një dimension të shprehur, ajo përqendrohet në reformat e administratës publike, duke përfshirë qeverisjen e mirë dhe nxitjen e bashkëpunimit dhe lidhjes rajonale. Reformat e administratës publike janë parashikuar si një grup programesh që synojnë të përmirësojnë cilësinë dhe llogaridhënien e qeverisë dhe shërbimeve publike, ndërkohë që bashkëpunimi rajonal në rritje midis vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe me vendet e BE-së duhet të rrisë zhvillimin e kapaciteteve dhe integrimin e tregjeve. *Perspektiva* e zgjerimit ofron gjithashtu angazhime të përbashkëta në fushën e infrastrukturës së transportit, energjisë dhe komunikimit elektronik.

*Perspektiva* e zgjerimit vendos theksin tek qeveritë të cilat duhet të sigurojnë pjesëmarrjen aktive të palëve të interesit në proceset e reformës dhe politikë-bërjes, duke krijuar, për shembull, mundësi për

dialogë gjithëpërfshirës dhe të strukturuar së bashku me një shoqëri civile të fuqizuar. Merret në konsideratë hierarkia e prioriteteve sipas vendit të qeverisjes territoriale.

*Perspektiva* e zgjerimit përmend shkurtimisht nevojën për ekuilibër ndërmjet qeverive qendrore, rajonale dhe lokale, por nuk shtjellon se si duhet të arrihet dhe mbështetet ky ekuilibër. Shtojca e *perspektivës* së zgjerimit (Plani i Veprimit për Mbështetjen e Transformimit të Ballkanit Perëndimor<sup>4</sup>) nuk i referohet haptazi Qeverisjes Territoriale, ndërkohë që veprimet e prioritetit të parë nuk e përmendin fare qeverisjen. Për më tepër, *perspektiva* e zgjerimit nuk trajton dimensionin hapësinor (urban dhe rural) të ekuilibrit ndërmjet niveleve të qeverisjes dhe as nuk përshkruan mënyrën si të demokratizohet vendimmarrja dhe si do të nxitet rritja e qëndrueshme ekonomike. Vendet e Ballkanit Perëndimor, me ekonomi që mbështetet në mënyrë të konsiderueshme në burimet natyrore, nuk mund të përparojnë drejt zgjidhjes së ndonjë prej çështjeve të mësipërme nëse zgjidhjet nuk janë të përfshira në kuadrin e **zhvillimit të qëndrueshëm rajonal, mbrojtjes së mjedisit dhe planifikimit dhe zhvillimit të përgjegjshëm hapësinor**. Këto nuk janë çështje të dorës së dytë për tu zgjidhur nëse reformat e tjera të ndjeshme politike zbatohen me sukses; këto përbëjnë **çështje thelbësore**. Trajtimi i këtyre çështjeve kontribuon në arritjen e një bashkimi më të fortë dhe më të plotë, përpara se të bëhet një bashkim më i madh. Pas krizës së vitit 2008 dhe çmimit të lartë që paguan disa vende të BE-së për shkak të zhvillimit territorial të pamatur dhe të papërgjegjshëm, efektet e mundshme të mos konsiderimit të këtij të fundit njihen mirë.

4 [https://ec.europa.eu/commission/sites/beta-political/files/annex-communication-credible-enlargement-perspective-western-balkans\\_en.pdf](https://ec.europa.eu/commission/sites/beta-political/files/annex-communication-credible-enlargement-perspective-western-balkans_en.pdf)



### III. Sfidat e Qeverisjes Territoriale në Vendet e Ballkanit Perëndimor

*Cilat janë sfidat aktuale / të pritshme të Qeverisjes Territoriale që duhen trajtuar për të siguruar zhvillim dhe integrim?*

*Perspektiva e zgjerimit të besueshëm dallon midis një sërë çështjesh, veçanërisht duke theksuar problemet me shtetin e së drejtës; ekonomitë e dobëta, jo konkurruese; dhe mosmarrëveshjet dypalëshe. Megjithatë, ka sfida të tjera që lidhen me Qeverisjen Territoriale që duhet të trajtohen për të siguruar zbatimin e suksesshëm të objektivave të *perspektivës* së zgjerimit. Çdo vend i Ballkanit Perëndimor ka sfidat e veta specifike, megjithëse disa prej tyre janë sfida të përbashkëta, dhe në disa aspekte janë të përbashkëta dhe me vendet e Evropës Jug-Lindore dhe Qëndrore, vende anëtare të BE-së. Këto sfida të përbashkëta përfshijnë:*

- Kapacitetet e pamjaftueshme teknike dhe menaxheriale në nivelet e qeverisjes vendore dhe qendrore, duke përfshirë kapacitetin e ulët për të thithur fondet e BE-së;
- Shtrirja e zhvillimit në të gjithë territorin në kurriz të tokës bujqësore dhe burimeve natyrore. Kjo shtrirje manifestohet në nivel lokal, por vjen si pasojë e mungesës së kuadrit qeverisës rajonal dhe planifikimit të dobët territorial kombëtar dhe rajonal që shpesh sjell rezultate rajonale negative, veçanërisht për sa i përket përdorimit të burimeve ujore dhe shpyllëzimit;
- Orientimi sektorial i zbatimit të politikave pa një dimension territorial, bashkëpunimi i dobët horizontal midis sektorëve dhe palëve të interesuara, si dhe qeverisja shumë e kufizuar në vend. Sfidat e qeverisjes janë të lidhura me çështjet e pushtetit dhe territorit,

ndërkohë që pabarazitë socio-ekonomike territoriale mbeten të larta;

- Mungesa e një vizioni zhvillimor në nivel kombëtar. Agjendat politike mbizotërojnë kundrejt një vizioni për zhvillim dhe integrim. Qeveritë janë ose të papërgatitura ose nuk janë të gatshme t'i qasën BE-së me analiza të bazuara në prova, procese gjithëpërfshirëse dhe orientime të politikave, të cilat jo vetëm që do të përmbushin detyrimet e integritit por gjithashtu do të sigurojnë interesat e brendshme dhe zhvillimin e qëndrueshëm; dhe
- Në të gjitha vendet është i pranishëm procesi i një qeverisje ri-centralizuese, autoritare dhe populiste. Kjo ka çuar në reforma të dobëta të qeverisjes kombëtare, decentralizimit fiskal, financave publike, planifikimit dhe zhvillimit të territorit, prodhimit dhe furnizimit të energjisë dhe qeverisjes së pyjeve, mes sektorëve të tjerë, duke ulur llogaridhënien sociale të aktorëve qeveritarë dhe duke dobësuar demokracitë lokale.

**Tabela 1. Sfidat Kryesore të Qeverisjes Territoriale dhe Integritit për Vendet e Ballkanit Perëndimor që pasqyrojnë pikëpamjet e anëtarëve të Rrjetit të TG-WeB**

<p><b>Shqipëria</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Mangësitë mes planeve dhe praktikës:</i> ekzistojnë shumë plane për zhvillimin territorial por ka burime të kufizuara financiare dhe njerëzore për zbatimin e tyre</li> <li>• <i>Orientimi i politikave sektoriale:</i> sfidat e qeverisjes lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me pushtetin dhe territorin; pabarazitë e shumta rajonale</li> <li>• <i>Bashkëpunimi i dobët, mungesa e qeverisjes sipas vendit:</i> bashkëpunimi i kufizuar horizontal dhe vertikal për shkak të mungesës së shkëmbimit të njohurive dhe tendencave të centralizimit</li> <li>• <i>Qeverisja e dobët ekonomike:</i> informaliteti, korrupsioni dhe politikat fiskale të paqëndrueshme çojnë në një mjedis të pasigurt për investime</li> </ul>
<p><b>Bosnja dhe Hercegovina</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Mungesa e vizionit:</i> politizimi i çështjeve të politikave dhe kapacitetet e pamjaftueshme pengojnë zbatimin e zhvillimit lokal.</li> <li>• <i>Decentralizimi asimetrik politik dhe fiskal:</i> kantonet dhe entitetet me më shumë autoritet dhe / ose fonde sesa qeveritë kombëtare dhe lokale</li> <li>• <i>Llogaridhënia politike dhe qytetare:</i> e kufizuar në të gjitha nivelet e qeverisjes</li> </ul>
<p><b>Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Decentralizimi i dobët fiskal:</i> komunat nuk kanë financimin e duhur për të kryer kompetencat e transferuara</li> <li>• <i>Mungesa e bashkëpunimit për shkak të politizimit:</i> bashkëpunimi ndër-komunal, ndër-rajonal dhe ndërkuftar janë në fazën fillestare</li> <li>• <i>Decentralizimi:</i> dështimi i shtetit për të nxitur decentralizimin, për të balancuar zhvillimin rajonal dhe për të forcuar kapitalin financiar vendor, njerëzor, social dhe teknik</li> </ul>
<p><b>Kosovë</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Kompetenca e kufizuar financiare:</i> korniza të ndryshme rregullatore janë zhvilluar edhe pse ka një mungesë të madhe të transferimeve financiare</li> <li>• <i>Bashkëpunimi ndërkuftar / ndër-rajonal:</i> mungesa e njohjes së shtetit në rajon kufizon lëvizshmërinë</li> <li>• <i>Linja etike:</i> nivelet e larta të pasigurisë për bashkitë e pjesës veriore sjellin vështirësi në qeverisjen dhe planifikimin territorial</li> <li>• <i>Pabarazitë territoriale:</i> mungesa e mundësive socio-ekonomike për grupe të ndryshme (të cënueshme).</li> </ul>
<p><b>Mali i Zi</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Centralizimi në planifikim:</i> e gjithë vendimmarrja për planifikimin dhe ndërtimin lokal kryhet nga Ministria e Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe e Turizmit</li> <li>• <i>Pabarazitë rajonale:</i> mungesa e politikave të zhvillimit rajonal; stanjacioni në pjesën veriore me pasoja ekonomike dhe demografike</li> <li>• <i>Privatizimi i hapësirës:</i> rrezikohet potenciali hapësinor dhe aksesit i publikut në këto vende; shfaqja e komuniteteve të mbyllura në kafaze</li> </ul>
<p><b>Serbia</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Pabarazitë rajonale:</i> politika e zhvillimit rajonal është joefektive; sistemi politik-administrativ është asimetrik</li> <li>• <i>Mungesa e efektivitetit të qasjes territoriale / vendore:</i> hartim i dobët i politikave dhe vlerësim i ndikimit</li> <li>• <i>Bashkëpunimi i dobët horizontal dhe vertikal:</i> iniciativa të paqëndrueshme të bashkëpunimit në hartimin dhe zbatimin e politikave</li> <li>• <i>Mungesa e llogaridhënies:</i> menaxhimi i bazuar në rezultatet brenda autoriteteve nën-kombëtare është dëmtuar</li> </ul>

## IV. Roli i Qeverisjes Territoriale në mbështetje të Perspektivës së Zgjerimit të BE-së për Ballkanin Perëndimor

*Pse dhe si mund të ndihmojë Qeverisja Territoriale për të ecur përpara / zbatuar strategjinë?*

Bashkimi me BE-në është më shumë se një proces teknik i kryer brenda zyrave të qeverisë, është një zgjedhje e gjeneratës së shoqërisë. Prandaj, siç e përcakton Strategjia, procesi kërkon që vendet të bashkojnë të gjitha palët e interesuara nga spektri politik, duke përfshirë shoqërinë civile, komunitetin, biznesin dhe median. Kjo është thelbësore pasi pranimi është një proces i bazuar në merita dhe kërkon që jeta e përditshme në Ballkanin Perëndimor të harmonizohet në mënyrë progresive me jetën e përditshme të Bashkimit Evropian. Për të siguruar këtë lloj konvergjence, harmonie, stabiliteti, atmosfere, mirëqenieje dhe barazie midis çdo vendi, njerëzit duhet të gëzojnë qasje të barabartë dhe të drejtë në shërbimet, vendimmarrjet, shfrytëzimin e burimeve, punësimin, mundësitë e arsimimit dhe aktivitetet sociale dhe kulturore. Këto janë të gjitha **tiparet e zhvillimit të arritshme përmes Qeverisjes Territoriale**.

Qeverisja Territoriale është një objektiv, vizion, dimension ose prioritet i disa dokumenteve strategjike dhe të njohura të Evropës, si Evropa 2020, Agjenda Territoriale 2010 dhe Vizioni Territorial Evropian 2050. Megjithatë, këto dokumente nuk i drejtohen rajonit të Ballkanit Perëndimor. Nëse e ardhmja e BE-së përfshin gjithashtu këtë rajon, atëherë **Qeverisja Territoriale e Ballkanit Perëndimor duhet të paraqitet në strategjitë Evropiane**, si edhe në çdo strategji që BE-ja parashikon për rajonin, duke përfshirë *perspektivën e zgjerimit*.

- Prioritet i shtetit të së drejtës nuk mund të arrihet vetëm duke trajtuar sistemin juridik dhe reformat ligjore. Ndërsa kjo është e nevojshme, lufta kundër korrupsionit duhet të ndodhë edhe në nivelin e: prokurimit dhe zbatimit të punëve publike (në një mënyrë të orientuar drejt procesit dhe të balancuar në mënyrë territoriale për të promovuar integrimin dhe zhvillimin e barabartë); vendimmarrjes vendore dhe rajonale mbi përdorimin e burimeve natyrore; sistemeve fiskale të ndershme dhe transparente dhe shpenzimeve që pasqyrojnë gjenerimin e të ardhurave; dhe në nivelin e zhvillimit territorial (duke marrë parasysh diversitetin social dhe territorial). Pas të gjitha, kjo është ajo që *perspektiva* e zgjerimit duhet të nënkuptojë kur i referohet **qeverisjes së përgjegjshme**.
- Qeverisja Territoriale është **e bazuar në vend dhe trajton dallimet territoriale**, qofshin ato natyrore, sociale, kulturore, historike apo etnike. Rajoni është i pasur në diversitetin e tij, i cili është një aset unik për zhvillimin e tij, por që shpesh herë krijon mosmarrëveshje. **Çdo reformë duhet të trajtojë këto diversitete dhe nuk duhet të zbatohet në mënyrë uniforme**. Për shembull, në Bosnjë-Hercegovinë, qeveritë lokale konsiderohen si institucionet më efikase dhe të besueshme politike, veçanërisht në krahasim me homologët e tyre në nivelin e kantoneve, në entitet dhe kombëtar. Megjithatë, qytetet dhe komunat mbesin të pa financuara. Qeverisja territoriale bazohet në **qasjet e decentralizuara**, të cila përforcojnë

demokracinë, sjellin efikasitet dhe rrisin parimin e partneritetit. Qeveritë e Ballkanit Perëndimor, nga ana tjetër, kanë treguar një tendencë të fortë në rritje të qeverisë së centralizuar (në vend që të zhvillojë mekanizmat e decentralizuar). Kjo ka shumë gjasa të pengojë zbatimin e Strategjitë së Zgjerimit.

- Përveç liberalizimit të vizave dhe gjyqësorit, pjesa më e madhe e reformave dhe programeve të BE-së qëndrojnë të padukshme për publikun. Është e domosdoshme që bashkëpunimi dhe **shkëmbimi transparent i njohurive ndërmjet BE-së dhe vendeve të Ballkanit Perëndimor** të përqendrohet në ato kapituj të *acquis* që kanë natyrë tematike dhe zhvillimore. Kjo qasje e integritetit duhet të pasqyrojë një karakter **vlerësimi sipas rendit nga poshtë lart**, në vend që të trajtojë thjesht vetëm aspektet formale dhe ligjore.
- Tregu rajonal dhe prioriteti i konkurrencës kërkojnë që infrastrukturën të integrojnë rajonin e Ballkanit Perëndimor në tregun e vetëm të BE-së gjerësisht nga zonat më të largëta dhe periferitë e brendshme, në qendrat kryesore urbane dhe shpërndarjet rajonale. Gjithashtu, kërkon investime të buta dhe të forta që promovojnë zhvillimin rajonal. Qeveritë lokale, rajonale dhe kombëtare duhet të investojnë dhe të mbështeten në zhvillimin e kapaciteteve për të parashikuar dhe zbatuar një **vazhdimësi funksionale territoriale, ekonomike** dhe sociale midis BE-së dhe Ballkanit Perëndimor.
- Zgjidhja e mosmarrëveshjeve dypalëshe nënkupton sigurimin e stabilitetit të brendshëm përpara hyrjes në një komunitet të ri. Mosmarrëveshjet dypalëshe kanë përparësitë historike

dhe kulturore dhe pasqyrojnë diversitet territorial brenda rajonit, i cili duhet të njihet dhe të llogaritet për strategjitë e zhvillimit, pavarësisht sfidave politike dhe kufijve politikë. Investimet duhet të përqendrohen në bashkëpunimin kulturor dhe arsimin, veçanërisht qendrave inovative të arsimit universitar dhe rrjeteve sociale për të gjitha segmentet e shoqërisë (sidomos për të rinjtë). **Bashkëpunimi është shoqëror**; nuk mund të ndodhë në një mënyrë lartë-poshtë, por duhet të ndodhë në shkallë të ndryshme territoriale dhe nivele institucionale. Bashkëpunimi dhe përfshirja e përgjithshme janë karakteristikat kryesore të Qeverisjes Territoriale dhe çojnë në dialogë harmonikë që lehtësojnë qeverisjen e mire dhe dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dypalëshe.

Zbatimi i *perspektivës* së zgjerimit përfshin një gamë të gjerë aktiviteteve dhe projektesh në nivel nën-kombëtar, paralele me planifikimin në nivel shtetëror (p.sh programet e reformave ekonomike, reformat e punësimit dhe sociale, etj.) dhe reformat rregullatore për t'u harmonizuar me standardet dhe ligjin e BE-së. **Qeverisja Territoriale ka të bëjë me zbatimin e këtyre aktiviteteve nën-kombëtare**. Në mungesë të tyre, perspektiva e zgjerimit mund të përfundojë duke pasur të njëjtin ndikim që raportohet shpesh herë në Raportet Vjetore të Progresit, progres i mirë në përafrimin ligjor (përgjegjësia në nivel kombëtar), por zbatim dhe progres i dobët ose i kufizuar i reformave në nivel shoqëror .

## V. REKOMANDIME:

### Qeverisja Territoriale në Ballkanin Perëndimor brenda kuadrit të Zbatimit të Perspektivës së Zgjerimit

*Cilat janë/mund të jenë prioritetet e Qeverisjes Territoriale ose ndryshimet në Qeverisjen që duhet të trajtohen në instrumentet e zbatimit të strategjisë?*

Në përputhje me argumentin e paraqitur më lart, përmirësimi i qeverisjes territoriale përbën një aspekt të rëndësishëm brenda një game të gjerë fushash të ndryshme të politikave. Fushat e temave më urgjente në të cilat qeverisja territoriale duhet të përmirësohet për të siguruar përparim drejt hartimit të politikave më efikase dhe integritimit evropian janë listuar më poshtë.

- **ZHVILLIMI RAJONAL DHE KOHEZIONI:** Suksesi i zbatimit të *perspektivës* së zgjerimit është në vetë duart e vendeve që aspirojnë për anëtarësim. Kjo kërkon krijimin e **sistemeve të hapura të informacionit** dhe kanaleve të komunikimit që ushqejnë politikat rajonale dhe të BE-së me perspektivat e Ballkanit Perëndimor. Ballkani Perëndimor duhet të bëhet pjesë e programeve të BE-së që mbështesin hartimin e politikave të bazuara në dëshmi siç është ESPON. Vendet e Ballkanit Perëndimor gjithashtu kërkojnë mbështetje për të arritur **kohezion territorial dhe zhvillim rajonal**. Ndonëse këto nuk mund të jenë subjekte të ndjeshme politike, ato janë në fakt subjekte që nxisin zhvillimin dhe bashkëpunimin horizontal midis sektorëve dhe palëve të interesuara për të arritur qëndrueshmërinë territoriale. Planifikimi për zhvillim duhet të bëhet një dimension i trajtuar nga *perspektiva* e zgjerimit, pasi është një hap vendimtar

për përgatitjen e Politikës së Kohezionit të BE. Së fundmi, vëmendja duhet t'i kushtohet **forcimit të qeverive për zbatimin e reformave**. Reformat e BE-së varen nga qeveritë e shteteve të anëtarësuar, por mbetet e paqartë se si pikërisht këto do të nxisin udhëheqësit politikë të ndryshojnë qasjen e tyre. Mbështetja e BE-së gjithashtu duhet të trajtojë drejtpërdrejt popullatën lokale, në vend që të fokusohet vetëm në institucionet qeveritare.

- **NDRYSHIMI KLIMATIK DHE MJEDISI:** Si një rrjet, ne besojmë se integrimi rajonal do të arrihet përmes **integritit ekonomik dhe social** të kombinuar me një **përdorim inteligjent të përbashkët të pasurisë natyrore** që karakterizon Ballkanin Perëndimor dhe qëndron në thelbin e sistemit të tij socio-ekologjik. Ky rajon po përballet gjithnjë e më shumë me efektet e ndryshimeve klimatike dhe shërben si një pengesë mbrojtëse për në brendësi të Evropës Juglindore. Fati i tij përcakton rrugëtimin e ardhshëm për brendësinë e tokës. Shkretëzimi, shpyllëzimi dhe ndryshimi i regjimeve të ujit rrezikojnë zhvendosjen e zonave subtropikale brenda në zonat e butë. Ekosistemi dhe qeverisja me përshtatje duhet të jenë pikat thelbësore për tu marrë në konsideratë në procesin e integritit, siç duhet diskutuar publikisht gjatë ndërveprimeve ndërmjet BE-së dhe Ballkanit Perëndimor.
- **ENERGJITË E RINOVUESHME DHE RREJETET E ENERGISË:** Territori i Ballkanit

Perëndimor ka **karakteristika të ndryshme natyrore**, të cilat përbëjnë **një burim të përbashkët për njerëzit që jetojnë në rajon** dhe janë shumë të rëndësishme për të ardhmen e Evropës. **Burimet e energjisë** janë një nga këto karakteristika. Vendet e Ballkanit duhet të jetojnë në sisteme të pastër të energjisë të cilat nuk shfrytëzojnë në mënyrë të paqëndrueshme burimet natyrore si uji, biomasa dhe toka prodhuese bujqësore. Brenda kuadrit të qeverisjes territoriale, BE-ja duhet të integrojë sistemet e saj të energjisë me Ballkanin Perëndimor, duke mbështetur vendet e Ballkanit Perëndimor për të krijuar dhe zgjeruar një sistem të bazuar në energjinë e rinovueshme. Kjo mund të kërkojë **kushtëzime në format aktuale të prodhimit të brendshëm të energjisë**, si kufizimi i përdorimit të lëndëve djegëse fosile, parandalimi i importimit të teknologjive të vjetra nga vendet e tjera dhe ndalimi i ndërtimit të hidrocentraleve në çdo nivel të rrymës. Parandalimi dhe zbutja e ndryshimeve klimatike, si dhe ekonomia qarkulluese duhet gjithashtu të marrin vëmendje të mëtejshme praktike.

- **MIGRIMI: Migrimi dhe kriza e vazhdueshme e refugjatëve është një sfidë qeverisëse për të gjithë** dhe duhet të trajtohet në përputhje me rrethanat. Kjo ka një efekt në territoret kombëtare (p.sh. menaxhimi i kufirit, kanaleve/ rrugëve / korridoreve të komunikimit, rrugëve dhe infrastrukturës së transportit, dhe burimeve natyrore); në qyteza, qytete dhe lagje (ku shpeshherë integrimi i emigrantëve dështon); dhe në kontekstin e brishtë socio-ekonomik të vendeve të Ballkanit Perëndimor Migrimi jashtë vendit për mundësi më të mira punësimi zvogëlon madhësinë e popullsisë dhe ndikon fuqinë punëtore në Ballkanin Perëndimor ndërkohë që kontribuon në pasiguritë e ardhshme

lidhur me një popullsi të plakur. Shtimi i temës së menaxhimit të refugjatëve në këtë kontekst të paqëndrueshëm të demografisë së brendshme rrit sfidat me të cilat ballafaqohet Ballkani Perëndimor në aspektin e zhvillimit të qëndrueshëm socio-ekonomik.

- **TREGU I PUNËS & PUNËSIMI:** Është e rëndësishme të përqendrohen investimet dhe mbështetja financiare e BE-së për sipërmarrjet e reja, NVM-të, infrastrukturën e lidhjes, arsimin (profesionet, universitetin dhe mbështetjen për institutet dhe iniciativat lokale të R & D), përmirësimin e burimeve natyrore dhe promovimin e menaxhimit të përbashkët të pishinave burime. Po aq e rëndësishme është edhe kanalizimi i fondeve drejt iniciativave që **parandalojnë ikjen e trurit dhe të mbajnë fuqinë punëtore vendase në Ballkan**. Programet e shkëmbimit janë me vlerë të lartë nga perspektiva e integritimit social, por ekziston edhe rreziku që të rinjtë të aplikojnë për vende pune në vendet e BE-së, në vend që të kthehen në vendet e tyre të origjinës. Prandaj, mbështetja duhet gjithashtu të përqendrohet në drejtim të punësimit, kërkimit, zhvillimit dhe edukimit cilësor brenda rajonit.
- **TRANSPORTI: Prioriteti i zgjerimit të lidhjes duhet t'i kushtojë vëmendje të veçantë sistemit të hekurudhave dhe autostradave** që lidh vendet e Ballkanit Perëndimor. Prioritet afatshkurtër i Ballkanit Perëndimor është lidhja e tij me korridoret evropiane për vazhdimësi të integruar territoriale. Kjo përbëhet nga një numër korridoresh rajonale: i) Split - Dubrovnik - Budva - Shkodër; ii) Split - Sarajevë - Beograd - Bukuresht; iii) Tiranë - Shkup - Sofje; Beograd - Prishtinë - Tiranë - Athinë; iv) Beograd - Shkup - Selanik

Së fundmi, instrumentet mbështetëse të BE-së për zbatimin e *perspektivës* së zgjerimit

duhet të sigurojnë **ekuilibrin e duhur të ndihmës midis niveleve të qeverisjes dhe palëve të tjera joqeveritare**, nëpërmjet mekanizmave konsultativë të besueshëm dhe efikasë, promovimit të aktiviteteve të të mësuarit dhe shkëmbimit të njohurive dhe mbështetjes për lëvizjet shoqërore që bëjnë thirrje për demokraci thelbësore lokale. Zbatimi i *perspektivës* së zgjerimit duhet të shoqërohet me instrumente të tjera. Kështu, kushtet e financimit kryesisht nga FMN-ja, Banka Botërore dhe EBDR duhet të përafrohen me përmbushjen e kriterëve të pranimit në BE. Kjo do të kërkojë koordinim dhe planifikim më efikas të donatorëve. Për më tepër, ekziston një nevojë për transferimin e njohurive si pjesë e zbatimit të instrumenteve territoriale si CLLD<sup>5</sup> dhe ITI<sup>6</sup>, bazuar në qeverisjen territoriale dhe politikën e kohezionit. Kjo do të forcojë kuptimin e **qasjes së bazuar në vend dhe parimit të partneritetit, të cilat janë thelbësore për qeverisjen territoriale**. Pa këtë të fundit, nuk mund të presim që *perspektiva* e zgjerimit të japë rezultate të ndryshme nga proceset e mëparshme të reformave.

---

5 Zhvillimi lokal nën drejtimin e komunitetit

6 Investime të Integruara Territoriale

## Shtojca 1

Lista e anëtarëve të organizatës TG-WeB dhe kontaktet përkatëse

**Emër Mbiemër**  
**Organizata**

**Rudina TOTO**

Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit  
+355 4 2407423; +355 4 2407424;  
www.co-plan.org

**Shteti**

Shqipëri

**Email**

rudina\_toto@co-plan.org

**Dritan SHUTINA**

Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit  
+355 4 2407423; +355 4 2407424;  
www.co-plan.org

Shqipëri

dritan\_shutina@co-plan.org

**Anila BEJKO**

Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit  
+355 4 2407423; +355 4 2407424;  
www.co-plan.org

Shqipëri

anila\_gjika@co-plan.org

**Aida CIRO**

Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit  
+355 4 2407423; +355 4 2407424;  
www.co-plan.org

Shqipëri

aida\_ciro@co-plan.org

**Ledio ALLKJA**

Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit  
+355 4 2407423; +355 4 2407424;  
www.co-plan.org

Shqipëri

ledio\_allkja@co-plan.org

**Lorena GJANA**

Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit  
+355 4 2407423; +355 4 2407424;  
www.co-plan.org

Shqipëri

lorena\_gjana@co-plan.org

**Besnik ALIAJ**

Universiteti Polis  
+355 4 240 7420/ +355 4 240 7421;  
www.universitetipolis.edu.al

Shqipëri

besnik\_aliaj@universitetipolis.edu.al



### **Ledian BREGASI**

Universiteti Polis  
+355 4 240 7420/ +355 4 240 7421;  
[www.universitetipolis.edu.al](http://www.universitetipolis.edu.al)

Shqipëri

[ledian\\_bregasi@universitetipolis.edu.al](mailto:ledian_bregasi@universitetipolis.edu.al)

### **Loris ROSSI**

Universiteti Polis  
+355 4 240 7420/ +355 4 240 7421;  
[www.universitetipolis.edu.al](http://www.universitetipolis.edu.al)

Shqipëri

[loris\\_rossi@universitetipolis.edu.al](mailto:loris_rossi@universitetipolis.edu.al)

### **Peter NIENTIED**

IHS - Erasmus dhe Universiteti Polis  
+31 614458559;  
[www.peternientied.com](http://www.peternientied.com)

Hollandë

[nientied1@chello.nl](mailto:nientied1@chello.nl)

### **Iván TOSICS**

MRI – Instituti i Kërkimeve Metropolitane  
+36 12179041 / 115;  
[www.mri.hu](http://www.mri.hu)

Hungari

[tosics@mri.hu](mailto:tosics@mri.hu)

### **Llazar KUMARAKU**

Universiteti Polis  
+355 4 240 7420/ +355 4 240 7421;  
[www.universitetipolis.edu.al](http://www.universitetipolis.edu.al)

Shqipëri

[llazar\\_kumaraku@universitetipolis.edu.al](mailto:llazar_kumaraku@universitetipolis.edu.al)

### **Sotir DHAMO**

Universiteti Polis  
+355 4 240 7420/ +355 4 240 7421;  
[www.universitetipolis.edu.al](http://www.universitetipolis.edu.al)

Shqipëri

[sotir\\_dhamo@universitetipolis.edu.al](mailto:sotir_dhamo@universitetipolis.edu.al)

### **Marko PETERLIN**

IPoP – Instituti për Politikat Hapësinore  
+386 59063682;  
[www.ipop.si/en/](http://www.ipop.si/en/)

Slloveni

[marko.peterlin@ipop.si](mailto:marko.peterlin@ipop.si)

### **Kai BÖHME**

Spatial Foresight  
+352 691873249;  
[www.spatialforesight.eu](http://www.spatialforesight.eu)

Luksemburg

[kai.boehme@spatialforesight.eu](mailto:kai.boehme@spatialforesight.eu)

### **Maros FINKA**

Universiteti Sllovak i Teknologjisë në Bratislavë  
| SPECTRA Qendra e Ekselencës BE në STU  
+421 905612465;  
www.stuba.sk, www.spectra-perseus.org

Sllovakia  
maros.finka@stuba.sk

### **Katarina OTT**

Instituti i Financave Publike  
+385 14819363, +385 14886444;  
www.ijf.hr

Kroaci  
kott@ijf.hr

### **Sonja DAMCHEVSKA**

Koalicioni për Zhvillim të Qëndrueshëm  
+389 25205246; +389 70365828;

Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë  
kor.csd@gmail.com

### **Erblin BERISHA**

DIST, Politekniku i Torinos  
+39 3294735827;  
www.dist.polito.it

Shqipëri, Itali  
erblin.berisha@polito.it

### **Elma DEMIR**

Shoqata për Kërkim Shkencor dhe  
Inovacion Social ADT  
+387 62469613;

Bosnje Hercegovina  
elma.demir@gmail.com

### **Marjan NIKOLOV**

Qendra për Analiza Ekonomike (CEA)  
+ 389 22444766; +389 71310974 ;  
www.cea.org.mk

Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë  
makmar2000@yahoo.com

### **Giancarlo COTELLA**

DIST - Departamenti Ndërunivesitar i  
Studimeve dhe Planifikimit Rajonal dhe Urban  
+39 0110907442 / 7442 ;  
www.dist.polito.it

Politekniku i Torinos, Itali  
giancarlo.cotella@polito.it

### **Bekim SALIHU**

GAP Instituti për Studime të Avancuara  
+381 38609339;  
www.institutigap.org/home

Kosovë  
bekim@institutigap.org

### **Aleksandra KAPETANOVIC**

EXPEDITIO, Qendra për Zhvillim Hapësinor të Qëndrueshëm  
+382 69454982; + 382 32302520/ 1;  
www.expeditio.org

Mali i ZI

office@expeditio.org  
sandra@expeditio.org

### **Tatjana RAJIĆ**

EXPEDITIO, Qendra për Zhvillim Hapësinor të Qëndrueshëm  
+382 69454982; + 382 32302520/ 1;  
www.expeditio.org

Mali i ZI

office@expeditio.org  
tanja@expeditio.org

### **Jelena BOJOVIC**

Aleanca Kombëtare për Zhvillimin Ekonomik Lokal  
+381 631074637;  
www.naled.rs

Serbi

j.bojovic@naled.rs

### **Dragisa MIJACIC**

InTER - Instituti për Zhvillimin Ekonomik të Territorit  
+381 113246766;  
www.regionalnirazvoj.org

Serbi

dmijacic@regionalnirazvoj.org

### **Biljana GLIGORIĆ**

EXPEDITIO, Qendra për Zhvillim Hapësinor të Qëndrueshëm  
+382 69454982; +382 32302520/1;  
www.expeditio.org

Mali i ZI

office@expeditio.org  
biljana@expeditio.org

### **Sonja DRAGOVIC**

EXPEDITIO, Qendra për Zhvillim Hapësinor të Qëndrueshëm  
+382 69454982; +382 32302520/1;  
www.expeditio.org

Mali i ZI

office@expeditio.org  
sonjadragovic@yahoo.com

### **Ana ILIC**

Aleanca Kombëtare për Zhvillimin Ekonomik Lokal  
+381 113373063; +381 641102992;  
www.naled.rs

Serbi

a.ilic@naled.rs

### **Jasna ŽARKOVIĆ**

InTER - Instituti për Zhvillimin Ekonomik të Territorit  
+381 113246766;  
www.regionalnirazvoj.org

Serbi

jzarkovic@regionalnirazvoj.org

**Edita STOJIĆ KARANOVIĆ**

Forum Ndërkombëtar Shkencor "Danubi -  
Lumi i Bashkëpunimit"

+381 112457042; +381 63661897;

[www.danube-cooperation.com](http://www.danube-cooperation.com)

Serbi

[office@danube-cooperation.com](mailto:office@danube-cooperation.com)

**Sanja KMEZIC**

EURAK Belgrade

[www.eurak.rs](http://www.eurak.rs)

Serbi

[sanja.govorusic@gmail.com](mailto:sanja.govorusic@gmail.com)

**Siniša TRKULJA**

Ministria e Ndërtimit, Transportit dhe  
Infrastrukturës

Serbi

[sinisa.trkulja@mgsi.gov.rs](mailto:sinisa.trkulja@mgsi.gov.rs)

**Velislava SIMEONOVA**

Qendra Ndërkombëtare Universitare e  
Barcelonës

[www.bcu.cat/en/](http://www.bcu.cat/en/)

Bullgari

[velislavasimeonova@gmail.com](mailto:velislavasimeonova@gmail.com)

**Ivaylo STAMENKOV**

Universiteti i Sofjes

[www.sofia.edu](http://www.sofia.edu)

Bullgari

[i\\_sta@abv.bg](mailto:i_sta@abv.bg)

**CIP Katalogimi në botim BK Tiranë**

The Western Balkans Network on Territorial Governance  
Position paper on Territorial Governance in the Western Balkans  
/ The Western Balkans Network on Territorial Governance.  
– Tiranë : Universiteti "Polis"

22 f. ; 0.5 cm.

Bibliogr.

ISBN: 978-9928-4459-7-1

1.Ekonomia rajonale                      2.Planifikimi strategjik  
3.Bashkëpunimi ndërkombëtar      4.Ballkani Perëndimor

332(497 -15)

711(497 -15)



WESTERN BALKAN NETWORK  
ON TERRITORIAL GOVERNANCE

---

© Rrjeti i Ballkanit Perëndimor për Qeverisjen Territoriale | TG-WeB |  
Shtator 2018